



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 479 Prot.

Tiranë, më 23.04 2018

**VENDIM Nr. 64, datë 20.03.2018**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.4, datë 20.03.2018, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Shkodra"2018*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtues Prof. Asoc. Saimir Shpuza dhe Prof. Piotr Dyczek i Univesitetit të Varshavës, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë.

**VENDOSI:**

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Shkodra"2018*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtues Prof. Asoc. Saimir Shpuza dhe Prof. Piotr Dyczek i Univesitetit të Varshavës, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
  - a) Gërmim arkeologjik në 5 pika në Kodrën e Bushatit:
    - Sondazhi 1 përkon me pikën më të lartë të murit rrethues të qytetit;
    - Sondazhi 2 në zonën ku gjatë vitit 2016 është kryer survejimi gjeofizik në një sipërfaqe prej rreth 500 m<sup>2</sup>;
    - Sondazhi nr. 3 do të kryhet në këtë pjesë të murit rrethues me qëllim datimin sa më të saktë të pjesës perëndimore të fortifikimit;
    - Sondazhi nr. 4 përkon me pjesën më të ulët të fortifikimit, por në të njëjtën kohë dhe me pjesën cilësore të tij ku dallohen qartë blloqet gëlqerore të permasave të mëdha dhe të punuara shumë mirë;
    - Sondazhi nr. 5 do të kryhet në terracën më të sheshtë të sitit. Duke gjykuar nga topografia kjo terracë përkon me një vend ideal ku do të ishin kryer ndërtimet kryesore të qytetit antik.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)

2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2018.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO TORXHI  
MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUBINA ZOTO



---

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)